



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 29.12.2014
Nr. 0204-1763

PËR: Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës
Islam Husaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës

LËNDA: KONFIRMIMI I LIGJSHMERISË SË RREGULLORES TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PEJËS Nr.06-57865/2014 të pranuar më datën 22.12.2014

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në nenin 81.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, pas shqyrtimit të rregullores Nr.06-57865/2014 të miratuar me datën 12.12.2014 nga Kuvendi i Komunës së Pejës, KONFIRMON ligjshmërinë e aktit, dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik është si vijon:

- Rregullorja komunale për Transparencë.

Me respekt,

Ljubomir Maric
Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 29.12.2014
Br. 0204-1763

ZA: **Gazmend Muhaxheri**, gradonačelnik Opštine Peć
Islam Husaj, predsedavajući Skupštine Opštine Peć

PREDMET: **POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE SKUPŠTINE OPŠTINE PEĆ,**
Br.06-57865/2014 dostavljen dana: 22.12.2014

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, na osnovu nadležnosti i odgovornosti određene po članu 81.4 zakona za lokalnu samoupravu, kao i uredbe br.02/2011, o poljima administrativne odgovornosti kancelarije premijera i ministarstva (prilog XII), nakon razmatranja odluke Br.06-57865/2014 usvojene dana 12.12.2014 od strane skupštine opštine Peć, **POTVRĐUJE** zakonitost akta i ceni da je isti u skladu sa zakonom za lokalnu samoupravu.

Pravni akt koji proizvodi puni pravni efekat je kao sledeće:

- Opštinska uredba za transparentnost.

S'poštovanjem,

Ljubomir Marić

Ministar administracije lokalne samouprave

Kopija: **Besnik Osmani**, generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljena MALS-a
Arhivi MALS-a



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEČ

HYRJESE-ULAZNA-INGOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data
Datum 22.12.2014
Date

Njësia organizative	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
-61-	203-1764	1	

RRËGULLORE KOMUNALE
Nr.03/2014 PËR TRANSPARENÇË

Pejë, Dhjetor, 2014



Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja c, nenit 68 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e dt.04.Qershor 2008"), nenit 9 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ nr.05/2013, për transparencën në komuna, të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, të dispozitave të nenit 9 paragrafi 9.1 shkronja c e Statutit të Komunës së Pejës 01.nr.09-8103 të dt.29. Shtator 2008. Kuvendi i Komunës së Pejës në mbledhjen e mbajtur me 12.dhjetor.2014, miratoi këtë:

RREGULLOREN KOMUNALE Nr. 03/2014 PËR TRANSPARENÇË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHMË

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është rritja e transparencës në punë të organeve të Komunës së Pejës: Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës, organeve të Administratës: drejtorive komunale, institucioneve arsimore dhe shëndetësore, ndërmarrjeve publike lokale dhe rritjes të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivel lokal.

Krijimi i rregullave që mundësojnë ushtrimin sa më të lehtë të mundshëm të kësaj të drejte, dhe zbatimi i praktikave të mira administrative për qasje në dokumente zyrtare.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo rregullore sqaron dhe precizon veprimet e transparencës së organeve komunale si: pjesëmarrjen e publikut në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, mbledhjet e publikut, obligimin për njoftim publik, konsultimet lidhur me aktet komunale, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në dokumente zyrtare të Komunës.

Neni 3 Përkufizimet

Me këtë Rregullore, shprehjet dhe shkurtesat e përdorura më poshtë kanë kuptimet si në vijim:

1. **“Mbledhjet e Kuvendit të Komunës”** - nënkupton mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës;
2. **“Komitetet”** – nënkupton komitetet e përhershme dhe komitetet tjera si trupa ndihmëse që i ndihmojnë Kuvendit dhe Kryetarit në përmbushjen e përgjegjësi-objektivave, të themeluara nga Kuvendi i Komunës në pajtim me Ligjin 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren për përmbajtjen dhe kompetencat e komiteteve;
3. **“Pjesëmarrja e publikut”** - nënkupton pjesëmarrjen e qytetarëve, shoqërisë civile dhe komunitetin e biznesit në vendimmarrje;
4. **“Njoftimi i publikut”** - nënkupton njoftimin e publikuar në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Komunës, publikimin e njoftimeve në gazetën e përditshme dhe në internet për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, të komiteteve, të organeve administrative, të institucioneve vartëse të Komunës dhe ndërmarrjeve publike lokale;
5. **“Tubime publike”** - nënkupton tubimet e organizuara nga organet e Komunës, organet e Administratës – drejtoritë, institucionet vartëse të Komunës dhe ndërmarrjet publike lokale, me qëllim të njoftimit për punën e bërë apo dhënien e propozimeve;
6. **“Peticion”** - nënkupton kërkesën e çdo personi apo organizate me interes në Komunë që ka të drejtë prezantimin e peticionit në Kuvendin e Komunës për çështjet që i adresohen Komunës në lidhje me përgjegjësitë dhe kompetencat e saj;
7. **“Konsultimi publik i akteve komunale”** - nënkupton seancën dëgjimore dhe marrjen e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të publikut para miratimit të aktit;
8. **“Qasja në dokumente zyrtare”** - nënkupton qasjen në dokumente zyrtare të Komunës, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike.

Neni 4 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të tij

4.1 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij janë të hapura për publikun dhe përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe subjektet e interesuara për çështjet që janë objekt diskutimi.

4.2 Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit të Komunës ose komitetit përkatës siguron pjesëmarrjen e publikut në mbledhjet e parapara.

4.3 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës ose të komitetit përkatës mund të jenë të mbyllura pjesërisht ose tërësisht nga publiku vetëm për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

4.4 Kuvendi ose komiteti përkatës me shumicën e votave merr vendimin dhe shpall mbledhjen pjesërisht ose tërësisht të mbyllura për publikun.

4.5 Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit të Komunës ose komitetit përkatës, nëpërmjet Zyrës për informim njofton publikun së paku 7 ditë para mbledhjeve të rregullta ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme ndër të tjera edhe përmes:

- a) Tabelës së shpalljeve të komunës;
- b) Shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës;
- c) Medieve të shkruara dhe elektronike lokale dhe
- d) Ueb – faqes zyrtare të komunës.

Neni 5

5.1 Njoftimet publike konform dispozitave të nenit 51 paragrafi 51.1 të Statutit të Komunës dhe nenit 4 paragrafi 5 të kësaj Rregulloreje, domosdo duhet të përmbajnë:

- a) Datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes;
- b) Rendin e ditës me materialin e mbledhjes.

5.2 Të gjitha propozimet e komiteve, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasje në dokumentet zyrtare, duhet të jenë në dispozicion për publikun sipas kërkesës.

Neni 6

Publikimi i akteve të Komunës

6.1 Statuti, rregulloret, vendimet dhe aktet tjera të Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilave nuk është i kufizuar me legjislacion në fuqi për qasje në dokumente publike, bëhen publike 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisjen lokale, ndër të tjera përmes:

- a) Tabelës së shpalljeve të komunës;
- b) Shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës;
- c) Medieve të shkruar dhe elektronike lokale dhe
- d) Ueb – faqes zyrtare të komunës.

6.2 Aktet nënligjore të komunës sipas paragrafit 1 të këtij neni hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisjen lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës.

6.3 Buxheti i Komunës dhe planet e komunës janë dokumente publike pa kufizime. Komuna duhet të sigurojë mjete financiare për t'i vënë këto dokumente në dispozicion të publikut, mjeteve të informimit dhe palëve të interesuara në formë të plotë ose të shkurtuar, sipas kërkesës.

UA
ni garë

6.4 Vendimi për aktet komunale në të cilat nuk lejohet qasja e publikut, mund të merret vetëm kur është në pyetje mbrojtja e interesit publik në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike.

Neni 7

Kërkesa për informim, iniciativat e qytetarëve dhe petition

7.1 Secili qytetar dhe person juridik që ka interes në Komunë, ka të drejtë që, me vetiniciativë, përmes formës së petitionit, t'i propozojë Kuvendit të Komunës nxjerrjen e akteve juridike, me të cilat do të zgjidheshin çështjet e rëndësishme për qytetarët e Komunës së Pejës.

7.2 Subjektet e përmendura më lartë, mund t'i drejtojnë petition Kuvendit të Komunës për çështjet që janë kompetencë e tij, në mënyrë të pa kufizuar, e që kanë të bëjnë me:

- a) Rregullimin e qytetit;
- b) Mirëmbajtjen e rendit dhe të infrastrukturës së komunës – qytetit;
- c) Urbanizmin e qytetit dhe të fshatit;
- d) Mirëmbajtjen e mjedisit jetësor;
- e) Zbatimin e vetëkontrollit dhe
- f) Çështjet të tjera të rëndësishme për jetën e popullatës vendore.

7.3 Një iniciativë e tillë e subjekteve fillon me nënshkrimin e tyre në formë të petitionit, me propozim të veçantë të çështjes së caktuar, dhe i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit të Komunës përmes Kryetarit të Komunës, respektivisht drejtorisë që është kompetente për këtë çështje.

7.4 Kur një petition nënshkruhet nga më shumë se 3000 (tremijë) qytetarë të regjistruar në listën e votuesve, e që ka të bëjë me çështjet që janë të lidhura me qytetin, Kuvendi i Komunës është i detyruar ta shqyrtojë çështjen.

7.5 Për çështjet që kanë të bëjnë me fshatra, vendbanime apo lagje të caktuara, peticioni duhet të shqyrtohet nga Kuvendi i Komunës, nëse atë e nënshkruajnë së paku 300 (treqind) qytetarë të regjistruar në listën e votuesve.

7.6 Nëse lagja, vendbanimi ose fshati ka më pak se 300 (treqind) banorë të regjistruar, peticioni do të jetë i vlefshëm nëse atë e nënshkruajnë 51% të banorëve të regjistruar në regjistrat e votuesve.

7.7 Çdo petition duhet të përmbajë emrin dhe adresën e parashtruesit-ve, emrin dhe adresën e nënshkruesit-ve, si dhe lëndën e petitionit. Lënda e petitionit duhet të ceket qartas në secilën faqe. Komunitetet mund t'i bëjnë petitionet Kuvendit të Komunës përmes Komitetit të Komuniteteve. Përmbajtja e petitionit duhet të jetë siç është caktuar më lartë. Një petition i cili nuk përmban elementet e duhura nuk konsiderohet i vlefshëm.

7.8 Drejtoria kompetente për çështjen që është objekt i petitionit, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga pranimi i petitionit, çdo petition të vlefshëm në aspektin formal do t'ia prezantojë Kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Përfaqësuesit e parashtruesve të petitionit kanë të drejtën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në mbledhje të komitetit dhe të Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të petitionit.

7.9 Vendimin përfundimtar për çështjen e kërkesës për informim, peticionit dhe iniciativës qytetare e merr Kuvendi i Komunës, në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e prezantimit në Kuvendin e Komunës, ndërsa ky vendim duhet të arsyetohet në formë të shkruar dhe t'u komunikohet parashtresve të tij.

7.10 Në përputhje me nenin 70 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale qytetarët mund të ndërmarrin iniciativë dhe të propozojnë rregullore për miratim në Kuvendin e Komunës. Draft - rregullorja shqyrtohet nga Kuvendi i Komunës vetëm nëse është firmosur nga 15 % e votuesve.

Neni 8 **Tubimet me publikun**

8.1 Komuna, në pajtim me dispozitat e nenit 68.1. të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitave të nenit 27 të Statutit të Komunës, mbanë dy tubime në vit me publikun për çështje të interesit të përgjithshëm, ku njëri nga këto tubime mbahet në 6 (gjashtë) mujorin e parë të vitit, ndërsa tjetri në 6 (gjashtë) mujorin e dytë, me kusht që ndërmjet tyre të ketë një interval kohor prej 3 (tre) muajsh.

8.2 Përveç dy tubimeve të detyrueshme me publikun, Komuna duhet të shqyrtojë mundësinë e mbajtjes së tubimeve shtesë me qëllim që të gjendet sa më pranë qytetarëve (vendbanimeve, fshatrave dhe lagjeve), për çështjet që lidhen me përdorimin e buxhetit të komunës, zhvillimit ekonomik lokal, përdorimin e pronës së komunës, planifikimin hapësinor, investimet, të hyrat e komunës, si dhe çështje tjera me interes të përgjithshëm.

8.3 Komuna siguron hapësira të njafshueshme brenda territorit të saj për pjesëmarrje të gjerë dhe aktive të publikut.

8.4 Dy javë para datës së mbajtjes së tubimit publik, Komuna nëpërmjet Zyrës për Informim njofton publikun ndër të tjera edhe përmes:

- a) Tabelës së shpalljeve të komunës;
- b) Shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës;
- c) Mediet të shkruara dhe elektronike lokale dhe
- d) Ueb- faqes zyrtare të komunës.

8.5 Njoftimi publik sipas nenit 8 paragrafi 4 të kësaj rregulloreje, përmban:

- a) Datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes;
- b) Rendin e ditës me materialin e mbledhjes.

8.6 Pjesëmarrja e zyrtarëve më të lartë të komunës si: Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Drejtori i Drejtorisë për Administratë, Drejtorët e drejtorive, kryesuesit e komiteteve, dhe zyrtarët kompetentë për çështjen në diskutim është e obligueshme.

8.7 Kërkesat, rekomandimet, vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga publiku gjatë tubimeve do të evidentohen nga personat e autorizuar dhe shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës në pajtim me dispozitat e statutit që rregullojnë çështjen e tubimeve me publikun.

Neni 9

Konsultimi publik para miratimit të akteve

9.1 Statuti, rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës të cilat janë në interes për publikun dhe publikimi i të cilave nuk kufizohet me legjislacionin në fuqi për qasje në dokumentet publike, i nënshtrohen diskutimit publik para miratimit.

9.2 Zyra për informim njofton publikun për mbajtjen e seancës së konsultimit publik.

9.3 Komuna, respektivisht Zyra për informim, do të vë në dispozicion të publikut të gjitha aktet e Kuvendit të Komunës si në paragrafin 1 të këtij neni, publikimi i të cilave duhet të bëhet në harmoni me paragrafin 4 dhe 5 të nenit 8 të kësaj rregullore. Të interesuarit mund të paraqesin rekomandimet, vërejtjet dhe sugjerimet për aktet që janë në konsultim publik, apo forma tjera të pjesëmarrjes së publikut.

9.4 Organi propozues i aktit merr pjesë aktivisht në konsultim, shpjegon përmbajtjen e aktit para publikut dhe evidenton propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve. Propozimet shqyrtohen brenda afatit të arsyeshëm nga përfundimi i konsultimit.

9.5 Vërejtjet e paraqitura në diskutim publik, shqyrtohen nga Organi Propozues i cili përgatitë raport me shkrim për propozimet e dhëna nga diskutimi publik, duke përfshirë propozimet e refuzuara dhe ato të cilat janë marrë parasysh nga ky organ.

9.6 Raporti me shkrim për propozimet e dhëna nga diskutimi publik duhet t'i dorëzohet për miratim Kuvendit të Komunës, i cili kujdeset që propozimet e argumentuara të përfshihen në tekstin përfundimtarë të projekt-aktit.

Neni 10

Qasja në dokumentet zyrtare të Komunës

10.1 Çdo kërkues, përfshirë personat fizik, personat juridik dhe grupet e interesit konform dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike dhe Statutit të Komunës së Pejës, mund të kenë qasje në informacione, respektivisht dokumente publike të Komunës, përfshirë edhe të drejtën për të qënë të informuar për politikat, vendimet dhe punën e organeve të administratës komunale.

10.2 Zyra për informim, pas pranimit të kërkesës, bënë shqyrtimit fillestarë të të njëjtës në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike.

10.3 Në rastet kur Organet e komunës nuk posedojnë informacionin apo dokumentin e kërkuar nga parashtruesi i kërkesës, detyrohen që në afat prej 5 (pesë) ditë pune nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim, t'ia dërgojnë të njëjtën organit që posedon informacionin, respektivisht dokumentin publik.

10.4 Organet e komunës obligohen që në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimi të kërkesës të nxjerr vendim për lejimin/refuzimin e qasjes në dokumentin e kërkuar.

10.5 Me rastin e refuzimit të plotë apo të pjesërishtë të kërkesës, organet e komunës, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, obligohen që ta njoftojnë parashtruesin e kërkesës për refuzim apo miratim të pjesërishtë të saj, duke e këshilluar për të drejtën e parashtrimi të kërkesës për rishqyrtim të vendimit në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga pranimi i të njëjtit.

10.6 Nëse me kërkesën e parashtruar kërkohen informacione që gjenden jashtë organeve të komunës apo kërkohen më shumë dokumente publike, afati për realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike mund të vazhdohet deri në 15 (pesëmbëdhjetë) dite.

10.7 Në rastet kur organet e komunës nuk përgjigjen në kërkesën e parashtruar brenda afatit kohorë të përcaktuar me këtë rregullore, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të inicioj procedurën para Institucionit të Avokatit të Popullit, Institucioneve tjera publike apo gjykatës kompetente.

10.8 Kjo Rregullore aplikohet për të gjitha dokumentet që mbahen nga organet kompetente të Komunës, të hartuara apo të pranuar nga këto organe, për të gjitha fushat dhe aktivitetet e Komunës, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Neni 11

Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare

11.1 Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare parashtrohet në formë të shkruar, duke e përshkruar informacionin që kërkohet, në mënyrë që Komuna ta identifikojë dokumentin, ndërkaq, parashtruesi nuk është i detyruar t'i japë arsyet për parashtrimin e kërkesës.

11.2 Nëse kërkesa nuk është e qartë dhe e saktësuar mirë lidhur me informacionin që kërkohet, organi kompetent kërkon nga parashtruesi që të qartësojë kërkesën.

11.3 Kërkuesi i ndonjë dokumenti ka të drejtën e mbetjes anonime ndaj palëve të treta.

Neni 12

Raportimi

12.1 Komuna harton raport vjetor për vitin paraprak, ku përfshihet numri i rasteve në të cilat janë lejuar qasjet, numri i rasteve në të cilat janë refuzuar qasjet në dokumente, si dhe arsyet e këtyre refuzimeve.

12.2 Komuna përmes njësisë përgjegjëse për komunikim me qytetarët, raportin vjetor nga paragrafi 1 i këtij neni ia dërgon njësisë përkatëse të Qeverisë së Kosovës/Zyrës së Kryeministrit më së largu deri në fund të muajit janar të viti përkatës.

Neni 13
Plani i Transparencës

13.1 Kryetari i Komunës miraton planin për forcimin e transparencës në Komunë. Shqyrtimi dhe miratimi i planit bëhet nga Kryetari i Komunës me qëllim që procesi i vendimmarrjes në organet e Komunës të bëhet me transparentë.

13.4 Me planet për transparencë, komuna i mundëson publikut monitorimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi nga komuna, duke përfshirë ndër të tjera legjislacionin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, prokurimin, shërbimin civil, qasjen në dokumente publike, ligjin mbi ndërtimin, ligjin për planifikimin hapësinor etj.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës janë përgjegjës për zbatimin e kësaj rregullore.

Neni 15

Në rast kolizioni në mes të dispozitave të kësaj rregullore dhe Ligjit si dhe Statutit të Komunës të cilat rregullojnë çështjen e transparencës, përparësi do të kenë dispozitat ligjore kundër atyre të kësaj rregullore.

Neni 16


Me hyrje në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja 01.Nr.020-5488 e datës 30. Qershor 2008 për Transparencë.

Neni 17

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I. Nr. 06 - 57865/2014
Me date 12.12.2014



KRYESUESI,
Dr. Islam Husaj